



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:179134
Datë: 12.02.2025
Numri i dokumentit: 06839026

C.2024:179135

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL, me gjyqtarin Driton Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani – Ismaili, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.H nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av.Arbnor Hasani nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj- Drejtoria e Arsimit, për objektin e kontestit pagesa në bazë të kualifikimit, vlera e pa përcaktuar, jashtë seancës me datën 12.02.2025, morri këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR, padia e paditëses B.H, e ushtruar kundër të paditurës Komuna Ferizaj- Drejtoria e Arsimit, për objektin e kontestit pagesa në bazë të kualifikimit.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 26.06.2024, kundër të paditurës ka ushtruar padi në këtë gjykatë për çështjen kontestimore pagesa në bazë të kualifikimit.

Gjykata me datën 30.01.2025 ka marr Aktvendim me anë të së cilës ka detyruar palën paditëse, që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të precizoj lartësinë e kërkesëpadisë duke përcaktuar lartësinë sipas çështjes kryesore si dhe periudhën kohore, si dhe me anë të njëjtimit aktvendim palën paditëse kanë të njoftuar me pasojat eventuale në rast mos respektimit të urdhrimit të gjykatës.

Nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi dhe bazuar nga dita e pranimi të këtij vendimi aktvendimi sipas flet dorëzimit të datës 30.01.2025, të pranuar nga i autorizuari i paditëses, shihet se ka kaluar afati kohor brenda të cilit paditësja, ka qenë e obliguar të veprojë, sipas aktvendimit 2024:179035 e datës 30.01.2025.

Andaj, bazuar në të lartcekura dhe konform dispozitës ligjore nga neni 391 par.1 pika g të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi me të cilën ka hedhur padinë e paditëses si të palejuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL
C.2024:179135, me datë 12.02.2025

Gjyqtari
Driton Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas ditës së pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëpërmjet të kësaj gjykate.